

Syllabusi i lëndës: Studime të familjes në perspektivë krahasuese

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Filozofik/Departamenti i Antropologjisë
Titulli i lëndës:	Studime të familjes në perspektivë krahasuese
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II / Semestri III
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Caktohet
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Tahir Latifi
Detajet kontaktuese:	tahir.latifi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë do të jetë e strukturuar në bazë të veçorive dalluese dhe/apo të ngjashme të formave të familjes, farefisnisë dhe martesës në perspektivë regjionale. Për më tepër, kjo lëndë fokusohet në linjën e Hajnal-it (John Hajnal 1965), që ndanë Evropën përmes dy arealeve, të karakterizuar nga moshat mesatare e martesës. Linja Perëndimore, ku mosha mesatare e grave në martesë të parë ka qenë 24 apo më shume, ndërsa e burrave 26, si dhe 10% apo me shume e te rriturve nuk janë martuar kurrë. Derisa në Linjën Lindore, mesatarja e martesës, për të dyja gjinitë (sekset) ishte më e hershme dhe martesja ishte pothuajse universale. Në kuadër të kësaj ndarje, më pas do të mësohet për veçoritë, format dalluese dhe strukturat e familjes për regjionet/nën-regjionet përkatëse. Kjo lëndë, gjithashtu, do të trajtojë format e farefisnisë; se si shoqëritë e ndryshme kanë specifikat e tyre sa i përket lidhjeve të farefisnisë; si dhe, se si format e farefisnisë ndikojnë edhe në organizimin social, politik dhe format e trashëgimisë.
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë ka për qëllim t'u ofrojë studentëve/eve njohuri bazë për sistemet e farefisnisë, format dhe ideologjitë e familjes. Përmes metodave krahasuese, do të shohim se, si format dhe ideologjitë e familjes janë të ndryshueshme dhe të modeluara nga elementë të religjionit, shtetit, proceseve të ndryshimit (nëpër kohë) dhe të ndikuar nga rrethanat ekonomike dhe politike apo/dhe migrimet. Për më tepër, kjo lëndë trajton ndryshimet në familje dhe marrëdhëniet farefisnore në kontekst të Kosovës, duke marrë në konsideratë ndryshimet e rëndësishme politike dhe socio-ekonomike, sidomos në periudhen e pas luftës 1998/99.
Rezultatet e pritura të nxënies:	– Në këtë lëndë studentët/tet do të jenë familjarizuar me njohuri bazë sistemet e farefisnisë, për format dhe

	<p>ideologjitë e familjes;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diskutim dhe njohuri për strukturën e familjes dhe të formave të ndryshme të saj, të regjioneve/nën-regjioneve përkatëse; - Roli i familjes dhe farefisit në kontekst të sigurisë sociale.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë
Ligjërata	25
Punë praktike	20
Ushtrime	20
Konsultime	10
Punë në shtëpi	10
Punime seminarike	10
Studime individuale	10
Puna në bibliotekë	25
Përgatitja e testeve	10
Ushtrime për provime	10
Totali i orëve	150

Metodologjia e mësimdhënies	Do këtë këtë ligjërime interaktiv, duke i bërë studentët aktiv gjatë ligjërimeve. Në varësi të mundësive që ka Universiteti i Prishtinës, do të organizohet edhe punë hulumtuese në terren, për të kuptuar praktikisht strukturat dhe ideologjitë e familjes dhe farefisit. Për më tepër, është paraparë që të ketë lexime përgatitore dhe hulumtime për tema përkatëse, të cilat më pas do të prezantohen, diskutohen dhe analizohen në ligjërime.
------------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi do të bëhet në bazë të suksesit të arritur gjatë gjithë semestrit. Studentët/tet do të mbledhin pikët, në bazë të suksesit së treguar në testet gjatë semestrit, punimeve seminarike (ose ese), pjesmarrjes aktive në ligjërime dhe ushtrime, përgatitjes paraprake – leximi (detyrë shtëpie) apo hulumtim studimor.
------------------------------	--

		Nota	Përshkrimi	Pikët
		10	(A) Shkëlqyeshëm	91-100
Ese %	20	9	(B) Shumë mire	81-90
Detyra dhe aktivitete në ligjërata	10	8	(C) Mirë	71-80

Testi gjysemsemestral %	35	7	(D)	Kënaqshëm	61-70
Testi final %	35	6	(E)	Mjafton	51-60
Total	100	5	(F, FX)	Mospërmbushje kriteri minimal	nën 51

Literatura

Literatura bazë:

- Backer, Berit (1979) 2003: *Behind the stone walls. Changing household organization among the Albanians in Yugoslavia*, Second Edition, Pejë, Dukagjini.
- Hajnal, John, 1965: ‘European Marriage Patterns in Perspective’, in David Victor Glass and David Edward Charles Eversley (eds.), *Population in History: essays in historical demography*, London, Edward Arnold LTD, p. 101-143.
- Kaser, Karl 2008: *Patriarchy after patriarchy. Gender relations in Turkey and in the Balkans, 1500-2000*, Vienna, LIT.
- Kaser, Karl 2012: *Household and Family in the Balkans. Two Decades of Historical Family Research at University of Graz*. Vienna, LIT.
- Krasniqi, Mark 1979: *Gjurmë e gjurmime*, Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Laslett, Peter 1972: *Household and family in past time*. Cambridge, Cambridge University Press.
- Reineck, Janet 1991: *The past as refuge. Gender, migration, and ideology among the Kosova Albanians*, Berkeley, University of California, PhD-thesis.
- Ulqini, Kahreman 2003: *Struktura e shoqërisë tradicionale shqiptare* [The structure of Albanian traditional society], Shkodër, Idromeno.

Literatura shtesë:

- Grandits, Hannes 2010: ‘Introduction: the reshaping of family and kin relations in European welfare systems’, in Hannes Grandits (ed.), *Family, kinship and state in contemporary Europe. The century of welfare: eight countries*, vol. 1. Frankfurt M.-New York, Campus, p. 23-46.
- Hammel, Eugene A. 1972: ‘The zadruga as process’, in Peter Laslett (ed.), *Household and family in past time. Comparative studies in the size and structure of the domestic group over the last three centuries in England, France, Serbia, Japan and colonial North America, with further materials from Western Europe*,

	Cambridge, Cambridge University Press, p. 335-373.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Temat
<i>Java e parë:</i>	Hyrje
<i>Java e dytë:</i>	Familja dhe shtëpia – qasje teorike
<i>Java e tretë:</i>	Modelet e familjes sipas Hajnal
<i>Java e katërt:</i>	Familja dhe farefisnia në Evropën Perëndimore dhe Amerikën Veriore
<i>Java e pestë:</i>	Familja dhe farefisnia në Azi, Amerikë Latine, Afrikë – karakteristikat kryesore
<i>Java e gjashtë:</i>	Familja dhe farefisnia në Botën Islame
<i>Java e shtatë:</i>	Familja dhe farefisnia në Evropën Lindore
<i>Java e tetë:</i>	Testi i parë/kollokuium
<i>Java e nëntë:</i>	Evropa Mediterrane
<i>Java e dhjetë:</i>	Familja dhe farefisnia në Ballkan
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Familja shqiptare
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Rolet gjinore brenda familjes shqiptare në Kosovë
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Familja dhe siguria sociale në Kosovë
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Migrimi dhe familja trans-nacionale
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Dorëzimi i eseve